



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 32
03 gusht – 09 gusht 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	20 / 20	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	12 / 13	92%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	26 / 28	93%
		Librazhd	12 / 12	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%

		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	10 / 11	91%
		Kukës	14 / 14	100%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	9 / 10	90%
		Kurbini	5 / 5	100%
		Mirditë	6 / 6	100%
	VLORE	Vlorë	22 / 22	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
		Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
		Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	424 / 429	99%

Tabela 2. Numri total i rasteve të sindromave të survejancës “Alert” në javën 32

	JAVA 32
Diarre pa gjak	4210
Diarre me gjak	0
Infeksione respiratore të sipërme	5013
Infeksione respiratore të poshtme	1500
Rash me temperaturë	12
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i njësive raportuese	424
% e njësive raportuese	99% (424/429)



Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuara për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:



Tiranë – 9 raste

Vlorë – 2 raste

Fier – 1 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave.**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 32 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 31.

Grafiku 3. Trendi në kohë i “diarreve pa gjak” sipas javëve.**Grafiku 4. Shpërndarja e “diarreve pa gjak” sipas grup-moshave.**


Prirja në kohë e “diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 32 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 31.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 20 – 32 të vitit 2025 dhe vitit 2026. Numri i rasteve.




Në javën 32 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).




Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 31/2026 dhe 32/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një ulje e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 20-32 të vitit 2025 dhe 2026. Numri i rasteve.



Në javën 32 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i ulët i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 31-32 2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Vlorë dhe Sarandë, ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat përkatëse të shëndetit publik. Kjo rritje vlerësohet se mund të lidhet me faktorët sezonalë dhe me lëvizjet më të shpeshta të popullsisë gjatë sezonit veror, periudhë gjatë së cilës rritet fluksi i pushuesve dhe frekuentimi i zonave bregdetare.

Gjithashtu, rritja e evidentuar mund të ndikohet edhe nga raportimi më aktiv i qendrave verore në sistem, të cilat gjatë kësaj periudhe raportojnë më shumë raste për shkak të shtimit të numrit të personave që kërkojnë shërbim shëndetësor. Situata mbetet në ndjekje të vazhdueshme për të vlerësuar dinamikën e rasteve dhe për të identifikuar në kohë çdo sinjal të mundshëm për grumbullim rastesh apo shpërthim epidemik.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda

- Deri më 6 gusht 2026, Republika Demokratike e Kongos (RDK) ka raportuar gjithsej 4 053 raste të konfirmuara me sëmundjen Ebola dhe 1 850 vdekje të konfirmuara, bazuar në të dhënat deri më 5 gusht 2026. Që nga fillimi i shpërthimit, janë prekur pesë provinca: Ituri, North Kivu, South Kivu, Tshopo dhe Haut-Uele.
- Në Ugandë, nuk janë raportuar raste të reja që nga 21 qershori 2026. Në total, vendi ka raportuar 20 raste të konfirmuara, përfshirë dy vdekje.
- Më 28 korrik 2026, Ministria e Shëndetësisë e Ugandës shpalli përfundimin e shpërthimit të sëmundjes Ebola në vend.
- Bazuar në informacionin aktual dhe duke marrë parasysh pasiguritë që lidhen me këtë shpërthim, rreziku i infektimit për personat nga Bashkimi Evropian dhe Zona Ekonomike Evropiane (BE/ZEE) që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura, vlerësohet i ulët. Duke qenë se mundësia e importimit të rasteve dhe e transmetimit dytësor në vendet e BE/ZEE është shumë e ulët, edhe rreziku i infektimit për popullatën që jeton në këto vende vlerësohet shumë i ulët. Ky vlerësim do të rishikohet nëse bëhen të disponueshme të dhëna të reja.
- ECDC vijon të monitorojë situatën përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemiologjike dhe bashkëpunon ngushtë me partnerët ndërkombëtarë për të mbështetur përgjigjen ndaj shpërthimit.

Survejanca sezonale e sëmundjes nga virusi Chikungunya – 2026 (Raport javor)

- Që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 5 gusht 2026, Franca është i vetmi vend në Evropë që ka raportuar raste autoktone (të fituara në vend) të sëmundjes nga virusi Chikungunya, me gjithsej 7 raste të konfirmuara.
- Gjatë javës së fundit, Franca raportoi 6 raste të reja autoktone të infeksionit nga virusi Chikungunya.


Situata vijon të monitorohet në kuadër të survejancës sezonale, veçanërisht në zonat ku është i pranishëm mushkonja *Aedes albopictus*, vektori kryesor i transmetimit të virusit në Evropë. Aktualisht, nuk janë raportuar raste autoktone në vende të tjera evropiane.

Survejanca sezonale e infeksioneve nga Virusi i Nilit Perëndimor (West Nile Virus – WNV) – 2026 (Raport javor).

- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit të vitit 2026 dhe deri më 7 gusht 2026, janë identifikuar 59 zona të prekura nga Virusi i Nilit Perëndimor (WNV) dhe 241 raste në shtatë vende të Evropës
- Shpërndarja e zonave të prekura dhe rasteve është si më poshtë:
 - Itali: 36 zona, 139 raste
 - Greqi: 9 zona, 61 raste
 - Rumani: 6 zona, 6 raste
 - Maqedoni e Veriut: 3 zona, 13 raste
 - Spanjë: 2 zona, 17 raste

- Francë: 2 zona, 4 raste
- Gjermani: 1 zonë, 1 rast

Situata epidemiologjike tregon një zgjerim gradual të aktivitetit të virusit gjatë sezonit veror, me Italinë që mbetet vendi me numrin më të madh të zonave të prekura. Survejanca epidemiologjike, laboratorike dhe entomologjike vazhdon në të gjitha vendet e prekura për të monitoruar përhapjen e virusit dhe për të mbështetur zbatimin e masave të kontrollit dhe parandalimit.



Survejanca sezonale e Etheve Hemorragjike Krime-Kongo (CCHF) – 2026 (Raport javor).

- Që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 5 gusht 2026, Spanja mbetet i vetmi vend në Evropë që ka raportuar raste autoktone të Etheve Hemorragjike Krime-Kongo (CCHF), me gjithsej 3 raste të konfirmuara.
- Gjatë javës së fundit, nuk janë raportuar raste të reja të CCHF në ECDC.

Situata epidemiologjike në Evropë mbetet e qëndrueshme, pa raportime të reja gjatë javës së fundit. Megjithatë, survejanca epidemiologjike dhe entomologjike vazhdon, veçanërisht në zonat ku është i pranishëm vektori (rriqnat e gjinisë *Hyalomma*), për të mundësuar zbulimin e hershëm të rasteve dhe zbatimin në kohë të masave të kontrollit dhe parandalimit.

Monitorimi sezonal i përshtatshmërisë mjedisore për rrezikun nga Vibrio spp. në ujërat bregdetare – Sezoni i plazhit 2026.

- Vibrioza shkaktohet nga bakteret e gjinisë *Vibrio*, të cilat gjenden natyrshëm në ujërat bregdetare, veçanërisht në mjedise të ngrohta dhe me ujëra me kripësi të ulët (brakishe). Në Evropë, këto baktere zbulohen më shpesh gjatë stinës së verës, ndërsa Deti Baltik paraqet kushte veçanërisht të favorshme për shumimin e tyre për shkak të kripësisë së ulët.
- Rritja e temperaturave si pasojë e ndryshimeve klimatike pritet të rrisë përshtatshmërinë e zonave bregdetare për rritjen dhe përhapjen e baktereve *Vibrio*, duke zgjeruar potencialisht zonat me rrezik për infeksion.
- ECDC monitoron vazhdimisht përshtatshmërinë mjedisore për zhvillimin e baktereve *Vibrio* në ujërat bregdetare të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane.